



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARRIV ARRIV ARRIVE		
Nr. Prot Buj. prot. Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. page	Data: Datum: Date: 02.03.2026
156	4	OIK
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA		

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4 dhe nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK, si dhe nenit 58 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2026, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE

PËR KRIJIMIN, KUNDËRSHTIMIN DHE KONFIRMIMIN E LISTËS VOTUESE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton të drejtën e votës, ndërrimin e Vendvotimit, si dhe procesin e krijimit, kundërshtimit, konfirmimit, publikimit dhe certifikimit të Listës Votuese.

Neni 2

Përkufizimet dhe shkurtesat

Për qëllim të kësaj Rregulloreje Zgjedhore, termat dhe shkurtesat e përdorura kanë këtë kuptim:

1. **“OIK”** – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësorë të Kosovës.
2. **“KQZ”** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OIK-ut, organ përgjegjës për organizimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen lidhur me procesin zgjedhor.
3. **“SKQZ”** – Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, strukturë administrative mbështetëse e KQZ-së.
4. **“KNJZ”** – Komisioni i Njesisë Zgjedhore, organ përgjegjës për administrimin e procesit zgjedhor në njësinë zgjedhore përkatëse.
5. **“Listë Votuese”** – listë zyrtare e përgatitur, publikuar dhe certifikuar nga KQZ, që përmban të dhënat e anëtarëve të OIK-ut me të drejtë vote.
6. **“Lista Preliminare Votuese”** – lista e përkohshme e votuesve e publikuar nga KQZ për qëllim të verifikimit dhe kundërshtimit.

7. **“Lista Përfundimtare Votuese”** – lista e votuesve e certifikuar nga KQZ pas përfundimit të procedurave të kundërshtimit.
8. **“Votues”** – anëtar i OIK-ut i cili plotëson kushtet ligjore dhe statutore për ushtrimin e së drejtës së votës.
9. **“Vendvotim (VV)”** – hapësira e përcaktuar nga KQZ ose KNJZ për ushtrimin e së drejtës së votës në ditën e zgjedhjeve.
10. **“Njësi Zgjedhore”** – bazë institucionale, territoriale ose profesionale e përcaktuar nga KQZ për organizimin e zgjedhjeve dhe përfaqësimin në Kuvendin e OIK-ut.
11. **“Proces zgjedhor”** – tërësia e veprimeve që përfshin krijimin e listës votuese, kundërshtimin, konfirmimin, certifikimin dhe përdorimin e saj në zgjedhje.
12. **“Rregullore”** – Rregullorja Zgjedhore për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës Votuese, e miratuar nga Kuvendi i OIK-ut.

Neni 3

E drejta e votës

Të drejtë vote për Kuvend kanë të gjithë anëtarët e OIK të cilët figurojnë në regjistrin e anëtarëve të Odës, në përputhje me rregullat zgjedhore.

Neni 4

Procesi i krijimit të Listës Votuese

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) mban Listën Votuese dhe siguron që ajo të bazohet në të dhëna të sakta, të përditësuara dhe të plota nga regjistri i anëtarëve të OIK dhe nga Komisionet e Njësive Zgjedhore që zgjedhin anëtarë.
2. Me qëllim të saktësisimit të Listës Votuese dhe konfirmimit të së drejtës për votim, KQZ kërkon informata nga baza e të dhënave të OIK dhe regjistrat e institucioneve që shërbejnë si njësi zgjedhore apo bazë deleguese për Kuvendin e OIK.
3. Lista preliminare votuese duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - 3.1. emrin dhe mbiemrin;
 - 3.2. numrin personal të identifikimit;
 - 3.3. datën e lindjes;
 - 3.4. gjininë;
 - 3.5. kodin dhe emërtimin e Komisionit të Njesisë Zgjedhore;
 - 3.6. elemente të tjera të përcaktuara nga KQZ.
4. KQZ mund të vendosë që listat publike të përmbajnë vetëm të dhëna të kufizuara nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 5

Ndërrimi i Vendvotimit

1. Sekretariati i KQZ-së u mundëson anëtarëve me të drejtë vote qasje në informatat e tyre lidhur me Vendvotimin ku janë caktuar dhe mundësinë për ndërrimin e tij.
2. Votuesi ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e Vendvotimit vetëm nëse nuk është në marrëdhënie pune me institucionin që shërben si njësi zgjedhore, ose në rast të papunësisë për shkak të ndërrimit të adresës së banimit.
3. Kërkesa për ndërrimin e Vendvotimit paraqitet brenda afateve të përcaktuara nga KQZ.

4. Kërkesa mund të bëhet në formë elektronike ose fizike, duke bashkëngjitur njërin nga dokumentet e identifikimit (letërnjoftim, pasaportë ose leje vozitjeje), si dhe dëshmi për gjendjen e të ardhurave mujore për gjashtë (6) muajt e fundit nga Trusti ose ATK.
5. Kërkesat shqyrtohen dhe miratohen nga KQZ.
6. KQZ organizon fushatë informuese për gjetjen dhe ndërrimin e Vendvotimit.
7. Për informimin e votuesve, KQZ aktivizon adresë elektronike për ofrimin e sqarimeve.

Neni 6

Publikimi i Listës Përfundimtare Votuese

1. KQZ, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, publikon Listën Përfundimtare Votuese në platformën elektronike.
2. Lista Përfundimtare Votuese përmban emrin dhe mbiemrin, numrin e licencës, Komisionin e Njësisë Zgjedhore dhe të dhëna të tjera të përcaktuara nga KQZ.
3. KQZ siguron qasje në Listën Përfundimtare Votuese për të gjithë anëtarët e OIK, duke respektuar Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. KQZ, me kërkesë të organizatave vëzhguese të akredituara ose vëzhguesve të kandidatëve, ofron qasje në Listën Përfundimtare Votuese.
5. Vëzhguesit janë të obliguar t'i trajtojnë të dhënat me konfidencialitet të librit votues.

Neni 7

Periudha dhe procesi i kundërshtimit

1. Gjatë periudhës së kundërshtimit, votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën Përfundimtare Votuese.
2. Afati për paraqitjen e kundërshtimeve përcaktohet nga KQZ dhe nuk mund të jetë më i shkurtër se tre (3) ditë.
3. Votuesi që nuk figuron në Listën Përfundimtare Votuese ose është caktuar gabimisht në Vendvotim tjetër, ka të drejtë të kërkojë rishikim pranë KQZ-së, duke u identifikuar me dokument të vlefshëm si në vijim :

- 3.1. letërnjoftim të vlefshëm;
- 3.2. pasaportë të vlefshme;
- 3.3. lejen e vozitjes të vlefshme.

4. Sekretariati i KQZ-së procedon menjëherë kundërshtimet e pranuar.
5. Çdo votues mund të kundërshtojë përfshirjen e një personi tjetër në Listën Përfundimtare Votuese, nëse pretendon se ai nuk ka të drejtë vote.

Neni 8

Procesi i vendosjes për kundërshtimet

1. KQZ njofton palën ndaj së cilës është paraqitur kundërshtimi dhe i jep mundësi për përgjigje.
2. Vendimet e KQZ-së u komunikohen palëve përkatëse pas përfundimit të shqyrtimit.
3. Vendimi i KQZ-së mund të ankimohet në Gjykatën e Nderit të OIK.
4. Gjykata e Nderit është organ përfundimtar administrativ, ndaj vendimit të së cilës mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatë.
5. Vendimet e Gjykatës së Nderit janë të detyrueshme për KQZ-në.

Neni 9

Certifikimi i Listës Votuese

1. KQZ cakton votuesit sipas rendit alfabetik nëpër Vendvotime.
2. Lista Votuese për secilin Vendvotim përmban:
 - 2.1. logon e KQZ-së;
 - 2.2. kodin e Vendvotimit;
 - 2.3. numrin e faqeve;
 - 2.4. numrin rendor;
 - 2.5. emrin dhe mbiemrin e votuesit;
 - 2.6. datën e lindjes;
 - 2.7. numrin personal të identifikimit.
3. Lista Votuese certifikohet nga KQZ jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve. Raporti i certifikimit të LV, përmban të dhënat si në vijim:
 - 3.1. llojin e zgjedhjeve;
 - 3.2. numrin e përgjithshëm të votuesve;
 - 3.3. numrin e vendvotimeve;
 - 3.4. Numrin e anëtarëve që zgjedh ajo njësi zgjedhore.

Neni 10

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore rregullohen me vendime të veçanta të KQZ-së.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prishtinë, 27.02.2026



Kryetare e OIK
Nexhmije Gori